

FLETORE ZYRTARE ELEKTRONIKE E QYTETIT TË SHKUPIT

Viti: 2014 **Numër:** 8

Data e lëshimit: 07/08/2014

Komuna: Këshilli i Qytetit të Shkupit

Lloji: Vendim

Titulli: VENDIM për rendin komunal të Qytetit e Shkupit

Tekst: Në bazë të nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02), e në lidhje me nenin 12 paragrafi (2) të Ligjit për veprimtari komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 95/12,163/13 dhe 42/14), Këshilli i Qytetit të Shkupit, në seancën e njëzeteshtatë, të mbajtur më 7 korrik 2014, miratoi

VENDIM

për rendin komunal të Qytetit të Shkupit

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Me këtë vendim përcaktohet rendi komunal i Qytetit të Shkupit, në kuadër të kompetencave, përkatësisht punët me interes publik me rëndësi lokale të Qytetit të Shkupit, e veçanërisht:

- rregullimi i lagjeve në qytetin,
- rregullimi, mirëmbajtja, pastrimi dhe shfrytëzimi i parqeve, kopshteve zoologjike, sipërfaqeve të gjelbra dhe rekreative dhe park pyjeve,
- mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve publike,
- mënjanimi i sendeve të vendosura në mënyrë kundërligjore dhe sendeve të lëna,
- kushtet për ruajtjen e kafshëve dhe kafshëve manare në oborre të objekteve banesore kolektive dhe individuale,
- mënyra e mbajtjes së pastërtisë në oborre, vende të objekteve banesore kolektive dhe individuale,
- mënyra e mirëmbajtjes dhe pastrimit të kanaleve të hapura të drenazhimit,
- masa për zbatimin e dispozitave të vendimit.

(2) Me këtë vendim nuk rregullohen çështjes e rendit komunal, përkatësisht marrëdhëniet në veprimtari të komunale që rregullohen me ligje të veçanta dhe me rregulla tjera të Qytetit të Shkupit.

Neni 2

Nocionet e përdorura në këtë vendim e kanë domethënien në vijim:

1. Sipërfaqe publike janë sipërfaqet në përdorim të përgjithshëm dhe sipas dedikimit janë:

- sipërfaqe publike të qarkullimit - rrugë, trotuare, vendkalime këmbësorësh, shtigje këmbësorësh dhe biçikletash, sheshe, shëtitore, nënkalime, mbikalime, ura, zona parkimi, shkallët që i lidhin sipërfaqet e qarkullimit publik, vendqëndrime të transportit urban publik, stacione të taksive dhe sipërfaqe të ngjashme;
- sipërfaqe të gjelbra publike - parqet urbane, park-pyjet, peizazhet karakteristik, lëndina, brezi tokësor pranë ose ndërmjet sipërfaqeve të qarkullimit publik ku është shtruar gjelbërimi, sipërfaqet e gjelbra në vende të hapura rreth objekteve publike, gjelbërimi mbrojtës në ledhe dhe në terren jostabil dhe sipërfaqe të ngjashme.
- pjesë përbërëse të sipërfaqeve të gjelbra publike mund të jenë zhardinierët, belvederët, vendpushimet, shkallët dhe shtigje dhe pajisje të ngjashme urbane dhe objektet
- sipërfaqe rekreative për sport, plazhe publike dhe sipërfaqe ujore, ;
- vende të hapura rreth objekteve publike .

2. Objekte janë ndërtesat e dedikuara për banim, kryerje të veprimtarisë, për akomodim dhe ruajtje të produkteve, aparateve dhe sendeve tjera të ngjashme nga veprimtari të ndryshme të prodhimit dhe shërbimit.

3. Nocionet objekte të infrastrukturës komunale dhe pajisjes urbane e kanë domethënien të përcaktuar në Ligjin për veprimtaritë komunale.

Neni 3

Veprimtaritë komunale bëhen në bazë të plan-programeve zhvillimore, në pajtim me Ligjin për veprimtaritë komunale ose ligj të veçantë me të cilin rregullohet veprimtaria komunale, si dhe rregullat e miratuara nga ana e Qytetit të Shkupit.

Neni 4

(1) Veprimtaritë komunale i kryejnë ndërmarrjet publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit (këtej e tutje: ndërmarrja publike) ose personat juridikë dhe fizikë që posedojnë leje për kryerje të veprimtarisë përkatëse, në pajtim me kushtet e përcaktuara në ligjin e veçantë me të cilin rregullohet veprimtaria e caktuar komunale ose në bazë të aktit të veçantë të Këshillit të Qytetit të Shkupit (këtej e tutje: subjekti i autorizuar).

(2) Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësisë e ndërsjella të Qytetit të Shkupit dhe subjektit të autorizuar të cilit i është dhënë leje, rregullohen me marrëveshje.

II. RREGULLIMI I LAGJEVE

Neni 5

(1) Lagjet e rajonit të Qytetit doemos duhet të rregullohen.

(2) Rregullimi i lagjeve, në kuptim të këtij vendimi, nënkupton:

- pjesë të jashtme të objekteve,
- sipërfaqet rreth objekteve,
- gardhet,
- gjelbërimi,
- sipërfaqet publike, objektet e infrastrukturës komunale dhe pajisja urbane e vendosur në to, si dhe në sipërfaqe të ngjashme, ndërtesa, aparate dhe pajisje, kështu që pamja dhe struktura ndikojnë në përmirësimin e pamjes së përgjithshme dhe rregullimit të lagjes.

1. Pjesët e jashtme të objekteve

Neni 6

(1) Pjesët e jashtme të objekteve, në kuptim të këtij vendimi janë: fasada dhe të gjitha elementet e fasadës, ulluqet, tarracat, ballkonet, lozhat, dritaret, dyert hyrëse, ekspozita dhe vende tjera të hapura të objekteve, tenda, çati, oxhakë dhe elemente tjera të çatisë, si dhe elemente tjera të jashtme të objekteve.

(2) Pjesët e jashtme të objekteve doemos duhet të mirëmbahen në mënyrë që të jenë të rregulluara dhe të pastra.

(3) Ndalohet dëmtimi i pjesëve të jashtme të objekteve, ndalohet shkrimi ose vizatimi në to i çfarëdo porosive dhe ngjashëm, shkarravitja, ngjitja e afisheve dhe ngjashëm ose në mënyrë tjetër të përdhosen dhe të dëmtohen.

(4) Ndalohet vendosja e mjeteve për tharje të rrobave, varje të rrobave, shtresave e mbulesave, perdeve, tepihëve dhe ngjashëm ose ekspozimi (lënia) e sendeve tjera në ose përmes pjesëve të jashtme të objekteve, në gardhet, dhe në oborret e objekteve që janë me pamje kah rruga ose sheshi.

(5) Ndalohet kryerje e çfarëdo punëve dhe ndërhyrjeve në pjesën e jashtme të objektit pa leje nga organi kompetent në pajtim me rregullat e ndërtimit, e në objekt të cilit i janë përcaktuar vlera monumentale ose ambientale ose gjendet në rajon të mbrojtur si kompleks monumental dhe pa pëlqim të institucionit kompetent për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

(6) Kujdesi për mirëmbajtje, shfrytëzim të rregullt dhe mbrojtje të pjesëve të jashtme të objektit është obligim i pronarëve dhe shfrytëzuesve të objektit, në pajtim me rregullat për banim.

Fasada

Neni 7

(1) Fasada nuk guxon të dëmtohet dhe duhet doemos të mbahet e rregullt dhe e pastër.

(2) Fasada dhe kallkani i objektit mund të dekorohet me mural, mozaik, pikturë, vizatime, vitrazh dhe ngjashëm, në pajtimit dokumentacionin e miratuar teknik.

Neni 8

(1) Në fasadën e objekteve për të cilat është lëshuar leje për përdorim, mund të vendosen afishe reklamuese dhe informative, nën kushte, mënyrë dhe procedurë në pajtimit me dispozitat e Ligjit për ndërtim, Ligjin për banim dhe rregullat e Qytetit për vendosje të afisheve të tilla.

(2) Për afishet e vendosura reklamuese dhe informative nga paragrafi (1) i këtij vendimi, paguhet taksë komunale, në pajtimit me vendimin e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

(3) Në pjesë tjera të jashtme të objekteve nga neni 6 paragrafi (1) i këtij vendimi, nuk lejohet vendosja e afisheve reklamuese dhe informative, përveç për shënim jokomercial ose reklamim të firmës personale ose prodhimit përkatësisht shërbimit të tij, në pajtimit me paragrafin (1) të këtij neni.

(4) Afishet reklamuese mund të ndriçohen.

(5) Afishet informative dhe reklamuese, sipas përmbajtjes së, shprehjes dhe porosisë së tyre, nuk guxojnë ta cenojnë moralin e njerëzve, e sipas formës, dimensionit, materialit dhe ngjyrës doemos duhet të përshtaten në mjedisin ekzistues dhe nuk guxojnë ta rrezikojnë sigurinë në komunikacion.

Dritare, ballkone, tarraca, lozha

Neni 9

(1) Në dritaret, ballkonet, tarracat, lozhat, rrethojat dhe pjesët tjera të ngjashme të objekteve, mund të vendosen dhe ruhen në ena adekuate për lule dhe bimë dekorative, në mënyrë që nuk do të dëmtohet objekti dhe pjesët e tij të veçanta dhe nuk do të rrezikohet siguria e qytetarëve dhe mjedisi si dhe siguria në komunikacion.

Ekspozitat

Neni 10

- (1) Ekspozitat e lokaleve afariste në objektet në objektet dhe vitrinat që shërbejnë për ekspozimin e mallit, doemos duhet të jenë të formuara në mënyrë teknike dhe estetike në mënyrë që të harmonizohen me pamjen e objektit dhe mjedisit, me ndriçim adekuat, të rregullohet dhe mirëmbahet në gjendje të rregullt dhe të pastër.
- (2) Ekspozitat e lokaleve afariste dhe vitrinat në katin përdhes të objekteve që janë me pamje kah rruga duhet të ndriçohen përderisa zgjat ndriçimi publik.
- (3) Ndalohet shkrimi i mesazheve dhe reklamave në ekspozitën, përveç atyre që shfaqin njoftime të përkohshme në lidhje me uljen e çmimeve ose reklamojnë kompaninë e dikujt ose produktin ose shërbimin e tij.
- (4) Nëse lokali afarist nuk përdoret, si dhe gjatë punëve të rinovimit të tij etj., ekspozita ose vitrina duhet të mbulohet me material të padukshëm ose në një mënyrë tjetër që të pamundësohet shikimi brenda.
- (5) Në ekspozitën nuk guxon të mbahet ambalazh ose të ruhet malli.
- (6) Ndalohet ekspozimi i mallit jashtë ekspozitës, përkatësisht lokalit afarist (në derën hyrëse, dritare, kornizën e ekspozitës etj.), pa leje për kryerje të veprimtarisë, përkatësisht jashtë lokalit afarist, që e lëshon kryetari i Qytetit të Shkupit.

Aparate

Neni 11

- (1) Kondicionerë, antenë dhe aparate solare, aparate për video mbikëqyrje dhe aparate dhe pajisje të ngjashme mund të vendosen në vend të dukshëm në pjesën e jashtme të objektit, në vende të parapara për atë dedikim sipas dokumentacionit teknik për objektin.
- (2) Për realizimin e punëve të vendosjes së aparateve nga paragrafi (1) i këtij neni në pjesën e jashtme të objektit të cilit i janë përcaktuar vlera ambientale ose monumentale ose gjendet në rajonin i mbrojtur si kompleks monumental, kushte dhe pëlqim jep institucioni kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- (3) Aparatet nga paragrafi (1) i këtij neni vendosen në mënyrë në të cilën nuk shëmtohet ose dëmtohet objekti ose objekti fqinjë dhe nuk rrezikohet siguria e komunikacionit dhe lëvizja e sigurt e këmbësorëve.

(4) Kondicioneri vendoset ashtu që të pamundësohet rrjedhja e ujit nga kondensimi nga aparati në pjesën e jashtme të objektit ose objektit fqinj, si dhe rrjedhja e drejtpërdrejtë në sipërfaqe publike.

Ndriçimi

Neni 12

(1) Ndriçimi i fasadës me numër më të madh të trupave ndriçuese mund të bëhet në përputhje me dokumentacionin teknik.

(2) Për realizimin e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni në pjesën e jashtme të objektit të cilit i janë përcaktuar vlera monumentale ose ambientale ose gjende4t në rajonin e mbrojtur si kompleks monumental, pëlqim jep edhe institucioni kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Flamuj

Neni 13

Në objektin mund të vendosen flamuj, nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me ligj ose rregull tjetër të miratuar në bazë të ligjit.

Tenda

Neni 14

(1) Në vende të hapura të pjesës së jashtme të objektit, në sipërfaqe publike, bahçe të objektit hotelierik, si dhe në plazhe, mund të vendosen tenda dhe çadra, nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me rregull të veçantë të Qytetit.

(2) Tendat dhe çadrat doemos duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt.

(3) Tenda, përkatësisht çadra nuk duhet të përmbajnë porosi reklamuese. Nëse tenda, përkatësisht çadra përmbajnë porosi reklamuese, pronari/shfrytëzuesi i tij është i detyruar që të paguajë taksë komunale.

Pasazhet

Neni 15

(1) Pasazhet dhe hapësira para hyrjeve në objektet doemos duhet të jenë të lira, të kalueshme tërësisht, të rregullta dhe të pastra.

(2) Në pasazhet dhe në hapësirën para hyrjeve nuk lejohet parkimi i automjeteve dhe lënia e çfarëdo sendeve ose materialit ndërtimor.

(3) Pasazhet dhe vendi para hyrjeve në objektet doemos duhet të ndriçohen përderisa zgjat ndriçimi publik.

2. Oborret dhe toka e pandërtuar ndërtimore

Neni 16

(1) Oborri, në kuptim të këtij vendimi, ndërsa pjesa tjetër e parcelës ndërtimore në të cilën është ndërtuar objekti, e rrethuar ose e parrethuar, në kuadër të së cilës mund të ketë kopsht, shtigje aksesi, shkalla, sipërfaqe për parkim të mjeteve të pronarëve përkatësisht shfrytëzuesve të objektit dhe elemente dhe përmbajtje tjera të ngjashme.

(2) Oborret dhe toka e pandërtuar ndërtimore, si dhe vendet/sipërfaqet që gjenden brenda ose ndërmjet bllokut banesor ose afarist ose ndërmjet objekteve, doemos duhet të mirëmbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër.

(3) Në sipërfaqet nga paragrafi (2) i këtij neni ndalohet lënia, hedhja, deponimi ose djegia e mbeturinave.

(4) Në oborret dhe në gardhet nuk lejohet vendosja e afisheve reklamuese dhe informative, përveç për shënim jokomercial ose reklamim të firmës personale ose produktit përkatësisht shërbimit të saj, pas lejes së marrë paraprakisht nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

(5) Në mënyrën e mirëmbajtjes së sipërfaqeve nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe pastërtisë së tyre aplikohen edhe dispozitat e neneve 91 dhe 92 të kapitullit "VII. Mënyra e mirëmbajtjes së pastërtisë në oborre, vende të objekteve banesore kolektive dhe individuale" të këtij vendimi, si dhe rregullat për pastërtinë publike, banimin, menaxhimin e mbeturinave dhe rregullat adekuate të Qytetit të Shkupit.

3. Gardhi

Neni 17

(1) Gardhi në sipërfaqe rreth objektit ose në tokë të pandërtuar ndërtimore që është me pamje kah rruga ose sheshi, duhet të përputhet stilistikisht me mjedisin, nuk guxon të bëhet me tel me gjemba, me thepa dhe ngjashëm dhe doemos duhet të vendoset në mënyrë që të mos e pengojë qarkullimin dhe lëvizjen e sigurt të kalimtarëve.

(2) Teli me gjemba ose thepa, me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, mund të vendosen vetëm si shtesë e gardhit ekzistues, në lartësi mbi 190cm.

(3) Pronari përkatësisht shfrytëzuesi është i detyruar që rrethojën që është me pamje kah rruga ose sheshi ta mirëmbajë në gjendje të rregullt, t'i riparojë dhe zëvendësojë pjesët e dëmtuara, rrethoja nga bimët gardhin nga bimë dekorative ta krasisë

rregullisht që të mos e kalojë vijën e rregullt e sipërfaqes publike dhe të mos paraqesë rrezik për kalimtarët.

4. Gjelbërimi

Neni 18

Gjelbërimit, si element të rregullimit të lagjeve i referohen dispozitat e kapitullit “III. Rregullimi, mirëmbajtja, pastrimi dhe shfrytëzimi i parqeve, kopshteve zoologjike, sipërfaqeve të gjelbra dhe rekreative dhe park-pyjeve “VII. Mënyra e mirëmbajtjes së pastërtisë në oborre, vende të objekteve banesore kolektive dhe individuale” të këtij vendimi.

5. Sipërfaqe publike, sipërfaqe tjera, objekte të infrastrukturës komunale dhe pajisja urbane

Neni 19

Sipërfaqeve publike, sipërfaqeve tjera, objekteve të infrastrukturës komunale dhe pajisjes urbane të vendosur në to, si dhe sipërfaqeve, objekteve, aparateve dhe pajisjes, si element i rregullimit të lagjeve u referohen dispozitat e kapitullit “IV. Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve publike” të këtij vendimi.

6. Dekorimi i qytetit

Neni 20

(1) Qyteti i Shkupit kujdeset për dekorimin e qytetit me rastin e festave shtetërore dhe datave tjera të rëndësishme, evenimenteve dhe manifestimeve dhe i siguron mjetet e nevojshme përmes programeve që i miraton Këshilli i Qytetit të Shkupit.

(2) Dekorimi bëhet me vendosjen e flamujve, trupave ndriçuese dhe elementeve tjera përkatëse.

(3) Dekorimin e bën ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar.

III. RREGULLIMI, MIRËMBAJTJA, PASTRIMI DHE SHFRYTËZIMI I PARQEVE, KOPSHTIT ZOOLOGJIK DHE SIPËRFAQEVE TË GJELBRA DHE REKREATIVE DHE PYJEVE-PARK

Sipërfaqet e gjelbra, parqet dhe pyjet-park

Neni 21

Në sipërfaqet e gjelbra nga neni 2 pika 1 nënparagrafi 2 e këtij vendimi shtrohet gjelbërim që nënkupton lëndina, plantacione të luleve dhe plantacione tjera, gardhe dekorative, shkurre, drurë dhe reshta drurësh

Neni 22

Mirëmbajtja e gjelbërimit përfshin:

- kultivimi dhe përtëritja e gjelbërimit;
- mbrojtja e gjelbërimit nga dëmtimet, sëmundjet dhe dëmtuesit ;
- rrallimi i drurëve në pyjet-park;
- pastrimi i sipërfaqeve të gjelbëruara;
- mirëmbajtja e objekteve, aparateve, instalimeve dhe pajisjes urbane që gjendet në sipërfaqet e gjelbëruara dhe mbrojtja e tyre nga dëmtimet;
- mirëmbajtja dhe pastrimi i shtigjeve në sipërfaqet e gjelbëruara.

Neni 23

(1) Punët e mirëmbajtjes, mbrojtjes dhe shfrytëzimit të gjelbërimit dhe sipërfaqeve të gjelbra publike i bën ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar në pajtim me rregullat, standardet dhe normat teknike që vlejné për këtë veprimtari dhe programin vjetor për rregullimin dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe sipërfaqeve tjera të gjelbra.

(2) Në programin nga paragrafi (1) i këtij neni planifikohen sipërfaqet publike për gjelbërim dhe përtëritje, llojet e gjelbërimit, vendosja dhe lloji i pajisjes urbane dhe punët tjera të mirëmbajtjes, si dhe shpenzimet për kryerje të këtyre punëve dhe burimet e mjeteve.

(3) Programin nga paragrafi (1) i këtij neni e miraton dhe e realizon ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar, në bazë të planit zhvillimor për kryerjen e veprimtarisë të cilin e miraton Këshilli i Qytetit të Shkupit për periudhë tri vjeçare.

(4) Programi nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet më së voni deri më 15 dhjetor të vitit vijues, për vitin e ardhshëm, pas pëlqimit paraprak të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Neni 24

Sipërfaqet e gjelbra në vende të hapura rreth objekteve publike, gjelbërimin në tokën ku të drejtë pronësie ose shfrytëzimi kanë ndërmarrjet dhe persona tjerë juridikë, gjelbërimin në komplekset banesore dhe në oborret e objekteve banesore individuale dhe kolektive që janë me pamje kah rruga ose sheshi janë të detyruar që t'i mirëmbajnë pronarët përkatësisht shfrytëzuesit e tokës në të cilën gjendet gjelbërimi.

Neni 25

(1) Në sipërfaqet e gjelbra nuk lejohet:

- shkulje, prerje dhe krasitje kundërligjore të drurëve, shkurreve dhe gardhit të gjallë;
- çfarëdo dëmtimi të gjelbërimit (zhveshja dhe prerja e kërcenjve, shkelje dhe të qëndruarit ulur në lëndina, këputja e luleve, shkulja e luleve dhe plisit me bar dhe

ngjashëm)

- degradimi i kushteve të bimëve (heqja e tokës dhe zbulimi i rrënjëve, mbulimi i kërcejve, ndryshimi i nivelit të ujit, ndryshimi i strukturës dhe përbërjes së tokës, etj.);
- mbledhja e fryteve dhe luleve nga drurët;
- gropimi dhe nxjerrja e dheut, gërryerja e kanaleve, kryerja e gërmimeve dhe ngjashëm;
- ndezja e zjarrit dhe ndezja e kërcejve
- hedhja dhe lënia e mbeturinave jashtë vendit të përcaktuara për atë dedikim;
- shkarkimi dhe lënia e mallit, ambalazhit, mbeturinave ndërtimore, materialit ndërtimor dhe për djegie dhe ngjashëm në ose pranë gjelbërimit;
- derdhja e ujit të papastër dhe lëngjeve tjera që e ndotin dhe e dëmtojnë sipërfaqen e gjelbër;
- ruajtja e kullotja e bagëtisë dhe shpendëve;
- që në drurët të vendosen, varen, shënohen ose ngjiten afishe reklamuese, mbishkrimi dhe pllakate;
- vendosja, riparimi, zëvendësimi dhe zhvendosja e objekteve, aparateve, instalimeve, pajisjes komunale, qoshqeve, afisheve reklamuese, mbishkrimeve, shenjave, udhërrëfyesve, kumtesave, dhe ngjashëm, pa leje;
- shkatërrimi dhe dëmtimi i objekteve, aparateve, instalimeve, pajisjes komunale, afisheve reklamuese, mbishkrimeve, shenjave, udhërrëfyesve, kumtesave dhe ngjashëm;
- kalimi, ndalimi, parkimi dhe lënia e çfarëdo lloji të mjetit dhe larja e tyre.

(2) Në hapësirën e pyllit-park dhe peizazhit karakteristik, përveç punëve nga paragrafi (1) i këtij neni nuk lejohet edhe:

- vrasja, persekutimi dhe shqetësimi i llojeve të kafshëve, shkatërrimi i formave të tyre të zhvillimit (larvat, vezët, këlyshët, çerdhet, foletë, etj.);
- ngritja e ndërtesave brenda kufijve të zonës së mbrojtur të pyllit-park Vodno, përveç objekteve me interes publik, të cilat nuk cenojnë integritetin, përkatësisht pamjen natyrore të malit;
- kullotja e bagëtisë, përveç në zonat e dedikuara për atë qëllim të përcaktuara me plani urbanistik;
- përpunimi i tokës jashtë vendbanimeve, i cili shkakton dëme dhe prish pyllin park Vodno;
- përdorimi i kimikateve të dëmshëm për zhvillimin e florës dhe faunës;
- shfrytëzimi i gurit, zhavorrit, rërës dhe tokës;
- përdorimi i burimeve, përveç për nevojat e zonës së mbrojtur;
- ndryshimi i hijezimit ekzistues të drurëve dhe bimëve (zhveshja e kurorës ose trungut, hijezimi i drurëve me ndërtesa ose pajisje, etj.);
- vendosja e trupave të huaj në trungje dhe degë (llamba, transportuesit të teltë, tabela, dollapë, antena, shkallët, etj.) dhe
- shfrytëzimi ekonomik i llojeve të drurit.

Neni 26

(1) Shkulja, prerja dhe krasitja e drurëve, shkurreve dhe gardhit të gjallë mund të bëhet për mirëmbajtjen ose përtëritjen e tyre të rregullt, nëse ato sulmohen nga insekte të dëmshme dhe sëmundje të bimëve, nëse janë të thata ose të dëmtuara nga moti i keq, nëse pengojnë instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, kur ekziston

rriziku i shkaktimit të dëmit njerëzor ose material, nëse pengojnë dukshmërinë e rrugëve dhe kalueshmërinë e trotuareve dhe shtigjeve, si dhe për shkak të ndërtimit të objekteve ndërtimi i të cilave lejohet në bazë të akteve të plotfuqishme administrative ose gjyqësore të miratuara paraprakisht, në bazë të aktit që e lëshon Kryetari i Qytetit të Shkupit.

(2) Me lejen nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen kushtet dhe mënyra e kryerjes së punëve, në pajtim me normat dhe standardet përkatëse.

(3) Në pyllin-park është peizazh karakteristik, krahas punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, prerja e drurëve mund të bëhet për shkak të kultivimit të pyllit.

(4) Në rast të shkuljes dhe prerjes së drurëve, shkurreve dhe ngjashëm, hapësira duhet doemos të rregullohet në mënyrë adekuate (të bëhet përtëritja përkatësisht zëvendësimi i tyre).

Neni 27

Për shkak të mbrojtjes së pyjeve-park, ndërmarrjet publike ose subjekti i autorizuar organizon shërbim të veçantë të rojës së pyllit i cili punon me ndërrime.

Neni 28

Regjimi i lëvizjes së mjeteve motorike në pyjet-park dhe zonat e mbrojtura, vendosja e rampave mbrojtëse dhe lëshimi i lejeve për qarkullim në zonat e mbrojtura, rregullohet me akt të kryetarit të Qytetit të Shkupit.

Neni 29

(1) Gjatë ndërtimit të objekteve të parapara në planin urbanistik, kontraktuese është i detyruar që, sipas rregullit, ta ruajë gjelbërimin që gjendet përreth, ta rregullojë, t'i ruajë instalimet dhe pajisjen komunale dhe para se të fillojë me ndërtimin t'i mbrojë, përkatësisht, pas mbarimit të punëve ndërtimore, ta kthejë gjelbërimin dhe pajisjen komunale në gjendjen e mëparshme, sipas masave për mbrojtje të përcaktuara në lejen nga neni 26 të këtij vendimi.

(2) Para fillimit të punëve, përfaqësues të autorizues të kontraktuesit, Qytetit të Shkupit dhe ndërmarrjes publike ose subjektit të autorizuar përpilojnë procesverbal për gjendjen e gjelbërimit dhe pajisjes komunale.

(3) Para marrjes së lejes nga neni 26 i këtij vendimi, kontraktuesi është i detyruar që në llogari të Qytetit të Shkupit të deponojë mjete ose të dorëzojë garanci bankare për mbrojtje cilësore përkatësisht për mbulim të shpenzimeve për kthim të gjelbërimit dhe pajisjes komunale në gjendjen e mëparshme.

Neni 30

(1) Nëse me ndryshimin e planit urbanistik ndryshohet dedikimi i sipërfaqes së gjelbër publike tanimë të formuar, përkatësisht mohohet gjelbërimi i shtruar, me planin urbanistik, caktohet sipërfaqe tjetër e parregulluar përkatëse dhe dedikohet për gjelbërim.

(2) Investuesi i cili ndërton objekt investues në sipërfaqen e gjelbër të ridedikuar publike, para marrjes së lejes për punë përgatitore, është i detyruar që në llogarinë e Qytetit të Shkupit të depozitohet mjete për rregullim në lokacion tjetër të parregulluar të paraparë për gjelbërim.

Neni 31

(1) Vendosja e rrjetit elektrik, të ujësjellësit, fekal, atmosferik, të telekomunikacionit, ngrohjes, gazsjellës dhe instalimeve tjera në sipërfaqe të gjelbra publike bëhet nëntokë, pas lejes së marrë nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

(2) Me përjashtim, instalimet e reja mund të vendosen edhe mbi tokë, kur është e nevojshme, për shkak të specifikës së terrenit dhe me kusht që ato të mos pengojnë zhvillimin e duhur të gjelbërimit dhe të mos prishin pamjen estetike dhe shfrytëzimin normal të zonave të gjelbra.

Neni 32

(1) Sipërfaqet e gjelbra publike mund të shfrytëzohen përkohësisht për mbajtjen e manifestimeve sportive, kulturore, argëtuese dhe manifestimeve, organizimeve tjera, etj., pasi marrjes së lejes paraprakisht nga Kryetari i Qytetit të Shkupit.

(2) Organizatori-kërkuesi i lejes për shfrytëzimin e sipërfaqes së gjelbër publike është i detyruar që me kërkesën të paraqesë pëlqim dhe dëshmi për rregullimin e detyrimeve për pagimin e taksës komunale dhe për pastrimin dhe kthimin e sipërfaqes së gjelbër publike në gjendjen e mëparshme (mjete të siguruara dhe depozituara për atë dedikim ose marrëveshje të lidhur me ndërmarrje publike ose subjekt tjetër të autorizuar ose dokument për përjashtim nga detyrimi).

Neni 33

(1) Në sipërfaqet e gjelbra publike, me përjashtim, përkohësisht (gjatë kohëzgjatjes së ngjarjeve nga neni 32 i këtij vendimi) mund të vendosen aparate të lëvizshme dhe pajisje të tjera (frigoriferë për akullore, makina shitjeje dhe tavolina për shitjen e pijeve, cigare, etj.), vetëm pas marrjes së lejes paraprakisht nga Kryetari i Qytetit të Shkupit, të lëshuar sipas elaboratit të miratuar.

(2) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni përmban veçanërisht: emërtimin, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e përdoruesit të mikro lokacionit; shënimin e mikro lokacionit; llojin e aparatit, përkatësisht aparatit që instalohet; lartësinë e çmimit që shfrytëzuesi duhet të paguajë për mirëmbajtjen e sipërfaqes, në përputhje me listën e përcaktuar të çmimeve; taksën komunale, kohëzgjatjen e lejes, etj.

Neni 34

(1) Shumën e mjeteve nga nenet 29 paragrafi (3), 30 paragrafi (2) dhe 32 paragrafi (2) të këtij vendimi, sipas standardeve ekzistuese për shtrimin e gjelbërimit për m², e përcakton me akt të saj ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar në përputhje me Qytetin e Shkupit.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) të këtij neni doemos duhet të përdoren për dedikimin për të cilin janë arkëtuar.

Neni 35

(1) Nëse në gjelbërim dhe në sipërfaqe të gjelbër publike haset bagëti ose shpend pa praninë e pronarit, ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar, me urdhër të inspektorit komunal të Qytetit të Shkupit, largon bagëtinë, përkatësisht shpendin nga sipërfaqja e gjelbër publike, e vendos atë në vend të veçantë të sigurt dhe e ruan atë (e ushqen dhe i jep ujë rregullisht, i ofron trajtim dhe kujdes shëndetësor) deri në 15 ditë, ndërsa pronari është i detyruar t'i kompensojë shpenzimet për kapjen dhe ruajtjen e bagëtisë, përkatësisht shpendit.

(2) Gjatë pranim-dorëzimit të bagëtisë, përkatësisht shpendit, pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i tij është i detyruar që të paraqesë dëshmi për identitetin e tij si dhe dëshmi/deklaratë për të drejtën mbi bagëtinë, përkatësisht shpendin.

(3) Pranim-dorëzimi bëhet pas pagesës së shpenzimeve për mënjanim, transportim dhe ruajtje të bagëtisë përkatësisht shpendit, gjegjësisht pas dokumentit të paraqitur për shpenzimet e paguara.

Neni 36

(1) Nëse pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i bagëtisë përkatësisht shpendit nuk është i njohur ose bagëtia përkatësisht shpendi nuk merret pas mbarimit të afatit nga paragrafi (1) i neni 35 të këtij vendimi, Qyteti i Shkupit do t'ia kompensojë ndërmarrjes publike ose subjektit të autorizuar shpenzimet e bëra për largimin, transportimin dhe ruajtjen e bagëtisë, përkatësisht shpendit.

(2) Pas skadimit nga paragrafi (1) i nenit 35 të këtij vendimi, Qyteti i Shkupit do t'ia besojë ruajtjen dhe shfrytëzimin e bagëtisë përkatësisht shpendëve personit të interesuar juridik ose fizik, nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me marrëveshje. Pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i bagëtisë përkatësisht shpendit mund ta marrë bagëtinë përkatësisht shpendin nga ky subjekt, pas pagesës së shpenzimeve për ruajtje nga ana e tij, si dhe shpenzimeve nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 37

(1) Organi drejtues i ndërmarrjes publike me akt të tij, i përcakton shpenzimet nga neni 35 i këtij vendimi.

(2) Pëlqim për aktin nga paragrafi 1 i këtij neni jep Këshilli i Qytetit të Shkupit.

(3) Kur mënjanimin e kryen subjekti i autorizuar, shpenzimet nga neni 35 i këtij vendimi, përcaktohet me marrëveshje ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe subjektit të autorizuar, në pajtim me ligjin.

(4) Pronari përkatësisht shfrytëzuesi i bagëtisë përkatësisht shpendit është i detyruar që krahas shpenzimeve për mënjanimin, transportimin dhe ruajtjen e tyre, të paguajë edhe kompensim të dëmit të cilin bagëtia, përkatësisht shpendët e kanë shkaktuar në gjelbërimin dhe sipërfaqen e gjelbër publike, sipas listës së çmimeve që e përcakton ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar në pajtim me Qytetin.

Kopshtet zoologjike

Neni 38

(1) Rregullimi, mirëmbajtja, pastrimi dhe shfrytëzimi i kopshteve zoologjike doemos duhet të bëhet në pajtim me rregullat nga sfera e mirëqenies së kafshëve dhe veterinarisë dhe pastërtisë publike, në mënyrë në të cilën do të shmanget ndikimi i dëmshëm i faktorëve të jashtëm të mjedisit jetësor (zhurmë, vibracion, ndotje atmosferike, papastërtia etj.).

(2) Mirëmbajtja e pastërtisë së sipërfaqeve të kopshtit zoologjik dhe higjiena e habitateve doemos duhet të bëhet në mënyrë përmes së cilës do të kufizohet rreziku nga paraqitja e sëmundjeve ose lëndimeve traumatike të kafshëve si dhe të sigurohen kushte për vizitë të këndshme dhe të sigurt të vizitorëve.

Neni 39

Për rregullimin, mirëmbajtjen, pastërtinë dhe shfrytëzimin e kopshteve zoologjike kujdeset institucioni përkatës.

Sipërfaqja ujore dhe rekreative

Neni 40

Sipërfaqet ujore dhe rekreative në rajonin e Qytetit të Shkupit (basene dhe liqene në kuadër të sipërfaqeve ekzistuese sportive-rekreative, si dhe liqenet dhe kanalet në parkun urban (e qytetit) duhet të mirëmbahen në gjendje të rregullt dhe funksionale.

Neni 41

Mirëmbajtja e sipërfaqeve ujore dhe rekreative në gjendje funksionale nënkupton:

- mënjanimi të llumit dhe pastërtisë nga sipërfaqja ujore dhe vija e saj bregore;
- të rregullohet shtigjet e këmbësorëve deri te liqeni;
- në sipërfaqet pranë basenit, përkatësisht liqenit të sigurohet dhe rregullohet hapësirë për pushim dhe rekreacion;

Kabinat dhe objektet tjera të jenë në gjendje të rregullt dhe të mund të shfrytëzohen sipas dedikimit dhe numrit të tyre t'i përgjigjet kapacitetit;

- dushet të jenë në gjendje të rregullt;
- nyjat sanitare të jenë të rregullta dhe numri i tyre t'i përgjigjet kapacitetit të basenit, përkatësisht liqenit;
- të ketë shporta të vendosura për mbeturina dhe të jetë e rregulluar zbrazja e tyre;
- gjatë periudhës së sezonit për not të ketë shërbim të organizuar për shpëtim dhe për ofrim të ndihmës së parë;
- të ketë lidhje telefonike

Neni 42

(1) Për mirëmbajtjen e rendit të hapësirës pranë basenit, përkatësisht vijës bregore rregullohet më afërsisht me akt të ndërmarrjes publike ose subjektit të autorizuar.

(2) Mënyra e punës dhe mirëmbajtjes së rendit të basenit, përkatësisht liqenit rregullohet më afërsisht me akt të ndërmarrjes publike ose subjektit të autorizuar.

(3) Pëlqim për aktin nga paragrafi (2) i këtij neni, jep Këshilli i Qytetit të Shkupit.

(4) Dispozitat e aktit nga paragrafi (2) i këtij neni theksohen në vend të dukshëm në hapësirën e basenit, përkatësisht liqenit, para fillimit të sezonit dhe gjatë sezonit, ndërsa shfrytëzuesit janë të detyruar që t'i respektojnë.

Neni 43

Ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar i cili i mirëmban dhe i shfrytëzon basenet dhe liqenet, ka për obligim që ta kontrollojë vazhdimisht rregullshmërinë kimike dhe bakteriologjike të ujit dhe për atë ta njoftojë publikun.

Neni 44

Në bazë të pasqyrës së rregullshmërisë teknike dhe higjienike të basenit përkatësisht liqenit dhe rregullshmërisë kimike dhe bakteriologjike të ujit, kryetari i Qytetit të Shkupit, me aktvendim konstaton nëse janë përmbushur kushtet për fillimin e sezonit për not.

IV. MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Neni 45

(1) Sipërfaqet publike nga neni 2 i këtij vendimi mirëmbahen dhe shfrytëzohen në pajtim me dedikimin e tyre.

Neni 46

(1) Sipërfaqet publike doemos duhet të mirëmbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër, që nënkupton veçanërisht:

- mirëmbajtje të pastërtisë publike,
- mirëmbajtje të gjelbërimit,
- riparim të pjesëve të dëmtuara,
- largim të mbeturinave ndërtimore dhe mbeturinave tjera,
- largim të mbeturinave të vajit dhe lubrifikantëve, parafinës dhe çamçakëzëve nga trotuaret, sheshet dhe shtigjet e këmbësorëve,
- ndërmarrja e punëve, si dhe të qenët i përmbajtur nga aktivitetet me qëllim sipërfaqja të jetë në gjendje të rregullt.

(2) Për gjendjen e rregullt dhe e pastër të sipërfaqeve të rregulluara dhe të ndërtuara publike kujdesen ndërmarrjet publike ose personat fizikë dhe juridikë të autorizuar me rregulla të veçanta të Qytetit, në pajtim me ligjin.

(3) Për gjendjen e rregullt të tokës së pandërtuar ndërtimore të dedikuar për rregullimin ose ndërtimin e objekteve publike ose sipërfaqeve publike është i

detyruar të kujdeset pronari, përkatësisht shfrytëzuesi (mbajtësi i drejtpërdrejtë) i asaj toke.

Neni 47

Ndalohet që në sipërfaqet publike pa leje ose në kundërshtim me lejen e lëshuar nga kryetari i Qytetit të Shkupit, të bëhen çfarëdo punë, përveç punëve të mirëmbajtjes së rregullt të atyre sipërfaqeve.

Neni 48

Në sipërfaqet publike, për shkak të mbrojtjes së tyre, ndalohet kryerja e çfarëdo lloji aktivitësh ose lëshimi i tyre, me ç'rast dëmtohet ose fëlliqet sipërfaqja publike, veçanërisht:

- lënia e materialit ndërtimor, sendeve dhe mbeturinave të ndryshme, si dhe çfarëdo lloji të pengesave,
- gjermim kundërligjor dhe lloj tjetër i dëmtimit,
- qarkullimi i mjeteve nëpër trotuare ose shteg këmbësorësh, korsi biçikletash dhe sipërfaqe të gjelbra, përveç vendeve të parapara, të përcaktuara dhe të shënuara për parkim,
- kullotja e bagëtisë.
- lënia dhe ruajtja e ambalazhit para ose jashtë objektit afarist,
- riparimi, servisimi dhe larja e automjeteve,
- lëshimi i ujërave të zeza,
- shitja ose ekspozimi i produkteve ose kryerja e veprimtarive para ose jashtë objektit afarist, përveç në raste, në kushte dhe në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me ligj ose rregull të Qytetit,
- vizatimi dhe shkrimi i porosive, reklamave ose teksteve tjera pa leje paraprake nga kryetari i Qytetit të Shkupit, përveç për sinjalizim horizontal të komunikacionit,
- vendosja kundërligjore e reklamave të lëvizshme dhe sendeve dhe pajisjeve tjera që e pengojnë lëvizjen dhe shfrytëzimin e lirë dhe të pandërprerë të sipërfaqeve publike,
- dëmtimi dhe ndotja e objekteve të infrastrukturës komunale, aparateve dhe pajisjes komunale,
- vendosja kundërligjore, ndërhyrjet, mënjanimi ose zhvendosja e objekteve të infrastrukturës komunale, aparateve dhe pajisjes, si dhe pengimi i vendosjes së tyre,
- dëmtimi dhe shkatërrimi i shenjave të komunikacionit, udhërrëfyesve, semaforëve dhe pajisjes tjetër që është në funksion të komunikacionit,
- hapja dhe mënjanimi i kapakëve të pusëve dhe vrimave në sipërfaqet publike,
- vendosja kundërligjore të objekteve ndihmëse (garazhe, kasolle, depo, hangar etj.)

Neni 49

Në sipërfaqet publike ndalohet:

1. pengimi i shfrytëzimit të rrugës me ndalim ose lënie të automjetit veçanërisht në:

- pjesën e trotuarit që nuk është shënuar për parkim, përkatësisht në vend parkimin jashtë vijave të shënuara të vend parkimeve; zonën e këmbësorëve; vendkalimeve për këmbësorë; korsive të biçikletave; zonën për trafik të qetë, përveç në vende të shënuara për parkim dhe ndalim,
- në stacionin e autobusit dhe tramvajit, stacionin e taksive; korsinë e trafikut të dedikuar veçanërisht për qarkullimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve.

2. ndalimi ose lënia e automjeteve në pjesën e sipërfaqes publike të trafikut në të cilën janë vendosur enë për plehra, në mënyrë të që ngritja/zbraza e plehrave nga enët,

3. ndalimi ose lënia e automjetit në pjesën e sipërfaqes publike që pengon shfrytëzimin e qarkullimit të këmbësorëve, hyrjen në objekte, hyrjen në objekt për shkak të ndërhyrjes së ambulancave, zjarrfikësve, policisë, shërbimeve publike, etj., hyrja e automjetit tjetër për shkak të parkimit ose dalja e automjetit nga parkingu ose oborri, etj.,

4. lëvizja, ndalimi ose parkimi i automjeteve në sipërfaqe të gjelbër publike, sipërfaqe të gjelbër rreth objekteve publike dhe sipërfaqe të gjelbër rreth objekteve banesore kolektive dhe afariste,

5. lëvizja e karrocave,

6. lënia e mjeteve të paregjistruara, që kanë pësuar avari ose të braktisura,

7. lënia e rimorkiove, kampshtëpizave, barkave, mjeteve të kampingut, makinave bujqësore etj.

Neni 50

Ndalohet që para, përkatësisht pranë ndërtesave dhe gardheve ose në ndërtesa dhe gardhe të vihen aparate ose sende që mund të lëndojnë kalimtarë ose t'u shkaktohen dëme, si dhe sendet e tilla të lihen në sipërfaqe publike.

Neni 51

Për mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, krahas dispozitave të këtij vendimi, zbatohen edhe dispozitat e ligjeve dhe rregullave tjera.

Objekte të infrastrukturës komunale, aparate komunale dhe pajisje komunale

Neni 52

(1) Në sipërfaqe publike në kompetencë të Qytetit të Shkupit, për shkak të sigurimit të funksionimit të veprimtarive komunale, rregullsisë, zbulimit dhe humanizimit të hapësirës, mund të ndërtohen, përkatësisht vendosen objekte të infrastrukturës komunale, aparate komunale dhe pajisje urbane.

(2) Objektet e infrastrukturës komunale, aparatet komunale dhe pajisja urbane ndërtohen, përkatësisht vendosen dhe mirëmbahen në pajtim me ligjet dhe aktet tjera përkatëse, si dhe rregullat (vendimet, rregulloret dhe programet) e Qytetit të Shkupit.

(3) Mirëmbajtjen e objekteve të infrastrukturës komunale, aparateve dhe pajisjeve komunale e bën ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar që janë të detyruara të mbajnë evidencë për gjendjen e infrastrukturës, aparateve dhe pajisjeve për ndryshimet e ndodhura dhe aktivitetet e ndërmarra.

(4) Vendosja e instalimeve elektrike, instalimeve të telekomunikimit dhe instalimeve tjera në sipërfaqe publike bëhet, sipas rregullit, nëntokë, pas lejes së marrë paraprakisht nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

(5) Me përjashtim të dispozitës së paragrafit (4) të këtij neni, instalimet e reja mund të vendosen edhe mbi tokë, kur është kjo e domosdoshme, për shkak të specifikës së terrenit dhe që të mos pengohet qarkullimi normal i trafikut dhe të mos e prishin pamjen estetike dhe shfrytëzimin normal të sipërfaqeve publike.

(6) Çezmat publike dhe shatërvanët kanë ujëmatës të tyre, tuba kullimi dhe qasje të rregullt.

Neni 53

(1) Mirëmbajtja e objekteve të infrastrukturës komunale, aparateve dhe pajisjes komunale nënkupton mirëmbajtje në gjendje të rregullt, të drejtë dhe funksionale.

(2) Për shkak të mbrojtjes së objekteve të infrastrukturës komunale, ndalohen aparate dhe pajisja komunale:

- thyerja e objekteve, aparateve dhe pajisjes,
- shkrimi, vizatimi dhe ngjyrosja lara-lara e objekteve, aparateve dhe pajisjes,
- ngjitja e afisheve, reklamave, shpalljeve dhe ngjashëm,
- larja e çezmave dhe shatërvanëve,
- furnizimi kafshëve me ujë në çezmat dhe shatërvanët,
- ndotja e ujit në shatërvanët,
- hedhja dhe lënia e mbeturinave,
- ndezja e zjarrit në objektet ose afër objekteve, aparateve dhe pajisjes.

Ndriçimi publik

Neni 54

(1) Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët magjistrale dhe mbledhëse dhe në sipërfaqet e gjelbra publike në Qytetin e Shkupit bëhet në pajtim me planet zhvillimore të Qytetit të Shkupit.

(2) Mirëmbajtja e ndriçimit publik në gjendjen e drejtë përfshin mirëmbajtje të objekteve dhe instalimeve, pastrim dhe zëvendësim të trupave ndriçuese (llamba dhe armatura), shënim (vendosja e numrave) pastrimi dhe ngjyrosja e shtyllave.

(3) Për shkak të mbrojtjes dhe funksionimit të pandërprerë të ndriçimit publik ndalohet:

- dëmtimi dhe shkatërrimi i trupave ndriçuese dhe shtyllave elektrike,
- lidhja vullnetare në rrjetin e ndriçimit rrugor,
- vendosja e shpalljeve, reklamave dhe ngjashëm, përveç me leje nga organi kompetent.

Gërmimi i sipërfaqeve publike

Neni 55

(1) Në sipërfaqet publike mund të bëhen gërmime dhe veprime të ngjashme për shkak të vendosjes, riparimit dhe zëvendësimit të instalimeve dhe objekteve infrastrukturore komunale, aparateve dhe pajisjes, vetëm me leje nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

(2) Me lejen nga paragrafi (1) i këtij neni caktohet afati për kryerje të gërmimit, masat për mbrojtje të pronës dhe qytetarëve, obligimi për incizim gjeodezik të instalimit nëntokësor, si dhe afati dhe mënyra e sjelljes së sipërfaqes publike në gjendjen e mëparshme.

(3) Investuesi i punëve nga paragrafi (1) i këtij neni është i detyruar që në llogari të Qytetit të Shkupit të depozitohet mjete për mbulimin e shpenzimeve për sjellje të sipërfaqes publike në gjendjen e mëparshme ose të sigurojë kontratë me ndërmarrje publike ose subjekt të autorizuar për kryerje të punëve të mirëmbajtjes së sipërfaqeve publike adekuate.

(4) Punët nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk mund të bëhen pas rregullimit të sipërfaqes publike, përveç në rast të nevojës për shkak të mënjanimi urgjent të defektit të infrastrukturës komunale.

Neni 56

Investuesi është i detyruar që kërkesës për gërmim të sipërfaqes publike t'i bashkëngjisë edhe dokumentacion të rregullt teknik dhe dëshmi për mjetet e depozituara ose kontratë të siguruar nga neni 55 paragrafi (3) i këtij vendimi.

Neni 57

(1) Kur është e domosdoshme të mënjanohen pasojat e krijuara nga ndikimi fuqisë madhore ose kur bëhet fjalë për defekt mosmënjanimi i të cilit mund ta rrezikojë

shëndetin dhe pronën e qytetarëve, lejohet gjurmimi në sipërfaqet publike pa leje nga neni 55 i këtij vendimi.

(2) Investuesi i punëve është i detyruar që në afat prej 3 ditësh nga dita e mënjanimit të pasojave nga fuqia madhore, përkatësisht defektit, të parashtrijë kërkesë me shkrim për lëshimin e leje për gjurmim.

Neni 58

(1) Në sipërfaqen publike mund të bëhen gjurmime, sipas rregullit, nga 15 mars deri më 15 nëntor.

(2) Me përjashtim, me leje të kryetarit të Qytetit të Shkupit mund të bëhen gjurmime edhe jashtë periudhës së përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, nëse për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme.

Vrima

Neni 59

(1) Për sigurinë e këmbësorëve dhe sigurinë në komunikacion të gjitha vrimat në karexhatat, trotualet dhe sipërfaqet tjera të komunikacionit, në parqe, në vende të hapura të objekteve publike, oborre, vendkalime dhe vende tjera të ngjashme doemos duhet të mbulohen me kapakë adekuate, grila ose lloj tjetër të kapakut.

(2) Vrima në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni konsiderohen veçanërisht:

- vrima për instalime të ujësjellësit, kanalizimit, instalime elektrike, të telekomunikimeve, ngrohjes, gazsjellësit dhe instalime dhe aparate tjera;
- vrima për hedhje të materialit për ngrohje dhe materialit tjetër, vrima për ndriçim të hapësirave (ndriçues horizontal) etj.

Neni 60

(1) Kapakët për vrimat nga neni 59 i këtij vendimi doemos duhet të përpunohen në atë mënyrë që ta pamundësojnë rrëshqitjen në sipërfaqet ku shkelim, të sigurohen (mbyllen), e nëse gjenden në karrexhatë doemos duhet të kenë edhe goma kundër zhurmës.

(2) Kapakët e dëmtuara doemos duhet të zëvendësohen.

(3) Gjatë kryerjes së punëve në vrimën, personi i cili kryen punët është i detyruar që ta rrethojë dhe shënojë me shenja të dukshme, ndërsa pas mbarimit të punëve ta mbyllë siç duhet vrimën dhe sipërfaqen rreth vrimës ta rregullojë dhe pastrojë.

(4) Për mirëmbajtje të vrimave nga neni 59 paragrafi (2) pika 1 kujdesen subjektet të cilëve u përkasin instalimet dhe aparatet në vrimën, ndërsa për vrimat nga neni 59 paragrafi (2) pika 2 kujdesen pronarët e hapësirave.

(5) Ndalohet dëmtimi, mënjanimi ose tjetërsimi i kapakëve nga neni 59 i këtij vendimi.

Manifestimet

Neni 61

(1) Sipërfaqet publike mund përkohësisht të shfrytëzohen për mirëmbajtje të manifestimeve sportive, kulturore dhe manifestimeve tjera, pas lejes së marrë paraprakisht nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

(2) Kërkuesi i lejes për shfrytëzimin e sipërfaqes publike është i detyruar që me kërkesën të dorëzojë dëshmi për rregullimin e detyrimeve për pagesën e taksës komunale dhe për sjelljen e sipërfaqes publike në gjendjen e mëparshme (mjete të siguruara dhe të depozituara për atë dedikim ose kontratë të lidhur me ndërmarrjen publike ose subjektin e autorizuar).

Kantier

Neni 62

Sipërfaqet publike mund përkohësisht të shfrytëzohen për nevoja të kantierit, si vende për shkarkim-ngarkim dhe vendosje të materialit ndërtimor, për parkim përkatësisht lënie të mjeteve dhe makinave të ndërtimit, për kryerjen e aktiviteteve ndërtimore, për ngritjen e skelave, për vendosjen e rrethojave në kantiere dhe ngjashëm, nëse kjo nuk është në kundërshtim me rregullat për sigurinë në komunikacion.

Neni 63

(1) Për punët nga neni 62 i këtij vendimi, me kërkesë të investuesit/kontraktorit, kryetari i Qytetit të Shkupit dhe investuesi/kontraktori lidh kontratë për qira afatshkurtër të tokës ndërtimore (sipërfaqes publike), në pajtim me Ligjin për tokë ndërtimore.

(2) Në kontratën definohe kohëzgjatja e qirasë, lartësia e qiramarrjes dhe kushtet tjera në lidhje me shfrytëzimin e tokës së marrë me qira.

(3) Organi kompetent për lëshimin e lejes për punë përgatitore sipas rregullave për ndërtim, nuk mund t'i lëshojë leje investuesit, përkatësisht kontraktorit për punë përgatitore, nëse nuk është lidhur paraprakisht kontratë nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 64

- (1) Gjatë realizimit të punëve nga neni 62 i këtij vendimi realizuesi mund të sigurojë kalueshmëri në trotuarin dhe në karrexhatën.
- (2) Sipërfaqja publike e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm doemos duhet të jetë e rrethuar.
- (3) Gardhi doemos duhet të mirëmbahet, e gjatë natës, si dhe gjatë kohës me mjegull, doemos duhet të shënohet (markohet) dhe të ndriçohet me më shumë drita të fiksuara me ngjyrë portokalli.

Neni 65

- (1) Gardhet në kantieret dhe skelat e ndërtimit (përfshirë edhe mbulesat mbrojtëse) të vendosura në sipërfaqe publike përkatësisht në sipërfaqe tjetër të cilat me pamje kah rruga ose sheshi, doemos duhet të jenë në gjendje të rregullt (të pastra, të padëmtuara, pa pllakate etj.).
- (2) Nëse punët kryhen në ndërtesë e cila është e përcaktuar si trashëgimi kulturore ose gëzon mbrojtje të veçantë ose gjendet në kompleks të mbrojtur historik kulturor ose ndërtesa ndërtohet në kompleks të tillë, mbulesa mbrojtëse e skelës doemos duhet të ngjyrosset me fasadën e objektit me përmasa 1:1.
- (3) Investuesi përkatësisht kontraktori është i obliguar të kujdeset për gjendjen e rregullt të gardhit të kantierit, skelës së ndërtimit dhe mbulesën mbrojtëse të skelës së ndërtimit.
- (4) Kalimi nën skelën doemos duhet të jetë i mbrojtur nga derdhja ose rënia e materialit, përkatësisht të vendoset në mënyrë që të mundësohet kalim i sigurt.

Neni 66

- (1) Realizuesi i punëve është i detyruar që të krijojë kushte që toka dhe materiali ndërtimor të mos shpërndahet në sipërfaqen publike.
- (2) Realizuesi i punëve doemos duhet që materialin ndërtimor ta sigurojë në mënyrë që të mos pengohet shkarkimi i ujit atmosferik.
- (3) Ndalohet lënia e materialit ndërtimor, mbeturinave ndërtimore, mbeturinave gabarite dhe mbeturinave tjera, përzierja e betonit dhe llaçit, ruajtja dhe puna me armatura dhe aktivitete tjera ndërtimore shoqëruese në sipërfaqe publike, jashtë sipërfaqes së lejuar për shfrytëzim, si dhe djegia ose në mënyrë tjetër trajtimi fizik dhe kimik i mbeturinave që krijohen gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtimore e që mund ta rrezikojë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe ta shëmtojë dhe çrregullojë vendin.

(4) Kontraktori është i detyruar që para marrjes së lejes për punët përgatitore, të sigurojë dëshmi për mënyrën në të cilën do të veprohet me mbeturinat ndërtimore dhe mbeturinat tjera inerte, që do të krijohet gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtimore, në kuptim të nenit 54 të Ligjit për menaxhim me mbeturina (ta mbledhë në mënyrë të mëvetëshme dhe ta transportojë mbeturinën ose t'ua dorëzojë personave të autorizuar juridikë dhe fizikë që mbledhin dhe transportojnë mbeturina).

(5) Tualetet e lëvizshme në kantieret doemos duhet të vendosen brenda në hapësirën e rrethuar dhe të jenë larg rrugëve ose shesheve nga objekti fqinjësor së paku 3 metra.

(6) Ndalohet lënia e materialit ndërtimor, mbeturinave ndërtimore, mbeturinave gabarite dhe mbeturinave tjera, pranë drurëve, si dhe shfrytëzimi i drurëve për kryerje të çfarëdo aktiviteti ndërtimor që shkaktojnë dëmtimin e tyre.

(7) Nëse punët ndërtimore, për çfarëdo arsye, ndërpriten më gjatë se 30 ditë, kontraktori (realizuesi i punëve) është i detyruar që ta mënjanojë skelën, rrethojnë dhe materialin tjetër dhe ta lirojë sipërfaqen publike.

Neni 67

Gjatë realizimit të punëve nga neni 62 i këtij vendimi, realizuesi është i detyruar që të ndërmarrë masa me të cilat do të pengohet fëlliqja e sipërfaqes publike, sidomos:

1. pastrimi, përkatësisht sigurimi i pastrimit të sipërfaqes publike rreth kantierit nga të gjitha llojet e materialeve ndërtimore dhe materialeve tjera, balta dhe të gjitha llojet e llumit që mbeten në sipërfaqen publike si pasojë e aktiviteteve ndërtimore në kantier;
2. spërkatja me ujë e materialit të gjysmërrënuar gjatë rrënimit të objekteve ndërtimore, me qëllim që të mos shkaktohet (ngrihet) pluhur;
3. pastrimi i pusëve të rrugës në afërsi të kantierit;
4. deponimi i materialit ndërtimor në kufijtë e kantierit, me qëllim për të mos e penguar komunikacionin, qarkullimin e lirë dhe derdhja e lirë e ujit dhe materiali të mos shpërndahet nëpër sipërfaqen publike;
5. pastrimi dhe larja e rrotave të përlyera të mjetit në kantierin para hyrjes së tyre në komunikacion.

Neni 68

Pas ndërprerjes së nevojës për shfrytëzim të sipërfaqes publike, investuesi përkatësisht realizuesi i punëve është i detyruar që ta njoftojë Qytetin për ndërprerjen e shfrytëzimit të sipërfaqes publike dhe të njëjtën ta lë në gjendje siç ka qenë para shfrytëzimit, përkatësisht para realizimit të punëve.

Ngarkim-shkarkimi (dorëzimi) i mallit

Neni 69

(1) Ngarkim-shkarkimi (dorëzimi) i mallit dhe materialit në pikën e shitjes ose magazinën, sipas rregullit, doemos duhet të bëhet jashtë sipërfaqeve publike.

(2) Me përjashtim, për shkak të mungesës së hapësirës ose rrugës së aksesueshme, ngarkim-shkarkimi i mallit dhe materialit mund të bëhet përkohësisht në sipërfaqe publike.

(3) Në rast se ngarkim-shkarkimi i mallit dhe materialit bëhet në sipërfaqe publike, malli, përkatësisht materiali doemos duhet të radhiten ashtu që të mos pengohet qarkullimi i mjeteve dhe i këmbësorëve dhe të mënjanohen më së voni në afat prej 30 minutash pas shkarkimit.

(4) Punët nga paragrafi (1) i këtij neni mund të kryhen vetëm pas lejes së marrë paraprakisht nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

Drurë dhe qymyr

Neni 70

(1) Ndalohet deponimi, çarja e druve dhe thyerja e qymyrit dhe sendeve tjera në sipërfaqet publike.

(2) Për shkarkim dhe deponim të druve të zjarrit, qymyrit dhe ngjashëm, si dhe për prerje dhe çarje të druve dhe thyerje të qymyrit, doemos duhet të shfrytëzohen oborret.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, kur për shkarkim të druve të zjarrit, qymyrit dhe ngjashëm nevojitet që të shfrytëzohet përkohësisht sipërfaqja publike, e njëjta doemos duhet të shfrytëzohet në mënyrë që të mos dëmtohet, si dhe të mos pengohet qarkullimi i mjeteve dhe këmbësorëve.

(4) Drutë, qymyri dhe ngjashëm doemos duhet të mënjanohen nga sipërfaqja publike brenda 24 orëve, ndërsa nga sipërfaqja e shfrytëzuar doemos duhet menjëherë të pastrohet tallashi dhe mbeturina tjetër.

Lëvizja e kafshëve manare në sipërfaqen publike

Neni 71

(1) Qentë dhe macet që ruhen si manarë mund të nxirren dhe të lëvizin në sipërfaqe publike në pajtime me dispozitat e këtij vendimi.

(2) Kafshët ekzotike dhe kafshët e egra që ruhen si manarë ndalohet të nxirren në sipërfaqe publike dhe jashtë hapësirës në të cilën qëndrojnë, përveç në raste të ndryshimit të vendqëndrimit dhe në rast të dërgimit në veteriner dhe atë vetëm në transportues adekuat të përshtatshëm për llojin dhe madhësinë e kafshës.

Neni 72

(1) Në sipërfaqet publike në rajonin e Qytetit të Shkupit qentë doemos duhet të jenë nën kontrollin e pronarëve, përkatësisht të jenë të lidhura me zinxhir.

(2) Me përjashtim, qeni i cili pa provokim paraprak tregon shenja të agresivitetit në kontakt me njerëzit dhe kafshët tjera, përkatësisht është me karakter të paparashikueshëm, dhe si i tillë, mund ta rrezikojë sigurinë e njerëzve ose kafshëve tjerë, krahas zinxhirit duhet të ketë edhe gojëz (maskë mbrojtëse).

(3) Pronari i manarit, si dhe personi i cili e shëtit qenin, mban përgjegjësi të plotë për sjelljen e tij në sipërfaqen publike dhe për dëmin eventual që do ta shkaktojë.

Neni 73

(1) Qeni mund të lëshohet nga zinxhiri dhe të lëvizë lirshëm:

- në park dhe në sipërfaqe tjetër të gjelbër, në periudhë nga ora 22:00 deri në ora 08:00 ditën tjetër në periudhën e llogaritjes verore të kohës, përkatësisht nga ora 18:00 deri në ora 09:00 ditën tjetër në periudhën e llogaritjes dimërore të kohës, nëse në atë sipërfaqe nuk është caktuar plotësisht, përkatësisht nuk është caktuar ndalim i pakufizuar kohor i lëvizjes së lirë të qenve dhe në sipërfaqe të gjelbër publike e cila është e caktuar për lëvizje të lirë të pakufizuar të qenve ose në sipërfaqe të ndërtuar për atë dedikim (këtej e tutje: park për qen).

(2) Ndalohet lëshimi i qenit nga zinxhiri dhe lëvizja e tij lirshëm në sipërfaqen e trafikut publik, në afërsi të drejtpërdrejtë të shkollës dhe objekteve tjera publike, në një pjesë të parkut ose sipërfaqe tjetër publike ku ka shesh lojërash për fëmijë, në pjesën me plantacion lulesh, si dhe në park dhe në sipërfaqe tjetër të gjelbër jashtë kornizës kohës të përcaktuar në paragrafin (1) nënparagrafi 1 të këtij neni.

(3) Qyteti i Shkupit, me propozim të komunave në qytetin e Shkupit ose ndërmarrjes publike ose subjektit të autorizuar të cilit i është besuar rregullimi dhe mirëmbajtja e gjelbërimit publik ose objektit, mund të caktojë sipërfaqe publike në të cilën ndalohet shëtitja e qenve (varreza përkujtimore, në sipërfaqe pranë përmendoreve dhe pllaka

përkujtimore, parterë të veçantë dekorues para institucioneve të rëndësishme publike, objekteve të shenjta etj.).

(4) Ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar nga paragrafi (3) i këtij neni është i detyruar që në parkun dhe në sipërfaqe tjetër publike të vendosë tabela në të cilat është shënuar në të cilat pjesë të sipërfaqes publike dhe në cilën periudhë kohore është ndaluar lëvizja e lirë e qenve, përkatësisht në të cilat sipërfaqe është ndaluar shëtitja e qenve, si dhe ta rregullojë dhe mirëmbajë parkun për qen nga paragrafi (1) nënparagrafi 2 i këtij neni.

Neni 74

Në parkun për qen ndalohet:

- futja e qenve të sëmurë;
- shfrytëzimi i parkut nga stërvitësit profesionalë të qenve për kryerje të stërvitjes së qenve;
- futja e ambalazhit të qelqtë;
- futja dhe lënia e ushqimit;
- qethja, pastrimi me furçë, krehja dhe llojet tjera të mirëmbajtjes së higjienës së qenve.

Neni 75

Në rajonin e Qytetit të Shkupit ndalohet sidomos:

- futja e kafshëve manarë në objekte dhe lokale:
 - që i shfrytëzojnë organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale,
 - në të cilat kryhet mbrojtja shëndetësore e qytetarëve,
 - në të cilat kryhet veprimtaria arsimore edukative,
 - në të cilat sigurohet llogaritja, qëndrimi dhe ushqimi i fëmijëve, nxënësve dhe studentëve,
 - për prodhim, ruajtje, kontroll dhe qarkullim të barnave,
 - për prodhim, ruajtje dhe qarkullim të produkteve ushqimore,
 - në objekte fetare,
- sjellja dhe futja e kafshëve manarë në objekte rekreative sportive, sipërfaqe ujore dhe tregje publike, si dhe në sipërfaqe të hapura të objekteve kulturore, arsimore, shëndetësore dhe objekte të ngjashme;
- shfrytëzimi i çezmave publike dhe shatërvanëve drejtpërdrejt nga kafshët manarë;
- qethja, pastrimi me furçë, krehja, larja dhe lloje tjera të mirëmbajtjes së higjienës të kafshëve manarë në sipërfaqe publike.

Neni 76

Pronarët e kafshëve manarë janë të detyruar që ta mënjanojnë jashtëqitjen e kafshëve nga sipërfaqet publike.

V. MËNJANIMI I SENDEVE TË VENDOSURA DHE TË LËNA NË MËNYRË KUNDËRLIGJORE

Neni 77

(1) Ndalohet vendosja kundërligjore dhe lënia e sendeve në sipërfaqet publike të qytetit të Shkupit.

(2) Sendet e lënda dhe ato të vendosura në mënyrë kundërligjore, mënjanohen.

Neni 78

Sende të vendosura dhe të lëna në mënyrë kundërligjore, në kuptim të këtij vendimi, janë sendet të cilat pa aprovimin e kryetarit të Qytetit të Shkupit janë vendosur dhe lënë në sipërfaqe publike, në objekte të infrastrukturës komunale dhe pajisjes urbane, dhe atë:

- stenda (rrotulluese) për shitje të gazetave, revistave, CD-ve dhe material tjetër të shtypur ose të incizuar,
- karroca për shitje të ushqimit të shpejtë,
- aparate për kokoshka, petulla, lesh sheqeri dhe ngjashëm,
- frigoriferë për akullore dhe pije
- tezgat statike dhe të lëvizshme, shporta, gajba dhe ambalazh tjetër,
- aparate për pjekje dhe zierje të gështenjave dhe misrit,
- aparate dhe pajisje tjera në funksion të kryerjes së veprimtarisë,
- reklama, udhërrëfyese, pllakate me shpallje dhe njoftime dhe ngjashëm,
- shtylla betoni/metali dhe lloj tjetër të pengesave dhe bllokuesve, zhardinierë etj.
- material ndërtimi dhe mbeturina të materialit të ndërtimit (rrënoja),
- tualete të lëvizshme,
- aparate dhe sende të vjetra të amvisërisë, sanitari, mobile
- dhe sende tjera të ngjashme

Neni 79

Në tokën dhe objekte në pronësi që janë me pamje kah rruga ose sheshi nuk lejohet lënia e sendeve që me pamjen dhe strukturën e prishin pamjen e përgjithshme të rrugës dhe lagjes (aparate të vjetra të amvisërive, sanitare, mobile, shporta, gajba dhe ambalazh tjetër, material ndërtimi dhe rrënoja dhe sende tjera të ngjashme).

Neni 80

(1) Me mënjanim e sendeve të vendosura dhe lëna në mënyrë kundërligjore në kuptimin e këtij vendimi, nënkuptohet ngritja, transportimi dhe vendosja dhe ruajtja e përkohshme e hapësirës e përcaktuar dhe e rregulluar në mënyrë të veçantë për atë dedikim.

(2) Punët nga paragrafi (1) i këtij neni i kryen ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar.

Neni 81

(1) Inspektori komunal i Qytetit të Shkupit, e urdhëron me shkrim pronarin, përkatësisht shfrytëzuesin e sendit të lëndë dhe të vendosur në mënyrë kundërligjore që ta mënjanojë në afatin e caktuar i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë.

(2) Nëse nuk dihet se kush është pronari, përkatësisht shfrytëzuesi, inspektori komunal i Qytetit të Shkupit shënon te sendi apo gjëja e lënë njoftim/vërejtje për detyrimin, afatin dhe procedurën e mëtutjeshme për mënjanimin e sendit.

(3) Pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i sendit të vendosur dhe lënë në mënyrë kundërligjore, është i detyruar që në afatin e caktuar nga inspektori komunal i Qyteti të Shkupit ose në afatin e caktuar në njoftimin nga paragrafi (2) i këtij neni ta mënjanojë sendin e vendosur ose lënë në mënyrë kundërligjore.

(4) Nëse pronari, përkatësisht shfrytëzuesi nuk e mënjanon sendin e lënë dhe të vendosur në mënyrë kundërligjore në afatin e caktuar, mënjanimin e kryen ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar me urdhër dhe në prezencë të inspektorit komunal të Qytetit të Shkupit, e për llogari të pronarit, përkatësisht shfrytëzuesit të sendit të vendosur dhe të lënë në mënyrë kundërligjore.

Neni 82

(1) Ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar është i detyruar që sendin e mënjanuar ta vendosë në vend të sigurt të dedikuar për vendosje të sendeve të tilla dhe ta ruajë deri në dorëzimin e tij te pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i sendit.

(2) Ruajtja e sendit nuk mund të zgjasë më gjatë se 15 ditë.

Neni 83

(1) Gjatë pranim-dorëzimit të sendit të mënjanuar i cili ka qenë i vendosur dhe i lënë në mënyrë kundërligjore, pronari, përkatësisht shfrytëzuesi tij është i detyruar që të paraqesë dëshmi për identitetin e tij, si dhe dëshmi/deklaratë për të drejtën mbi sendin.

(2) Pranim-dorëzimi i sendit bëhet pas pagimit të shpenzimeve për ngritje, transportim dhe ruajtje të sendit të mënjanuar, përkatësisht me dokument të paraqitur për shpenzimet e paguara.

(3) Nëse nuk dihet se kush është pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i sendit ose sendi nuk merret pas mbarimit të afatit nga neni 81 paragrafi (3) dhe 82 paragrafi (2) të këtij vendimi, Qyteti i Shkupit do t'ia kompensojë ndërmarrjes publike ose subjektit të autorizuar shpenzimet e bëra për mënjanimin dhe ruajtjen e sendit.

(4) Pas mbarimit të kohës nga paragrafi (2) neni 82 të këtij vendimi, Qyteti i Shkupit do t'ia besojë ruajtjen dhe shfrytëzimin e sendit të mënjanuar personit të interesuar fizik ose juridik, në kushte dhe mënyrë të përcaktuara me marrëveshjen. Pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i sendit të mënjanuar mund ta marrë sendin nga ky subjekt, pas pagesës së shpenzimeve të bëra për ruajtje nga ana e tij, si dhe shpenzimet nga paragrafi (3) i këtij neni.

Neni 84

(1) Organi Drejtues i ndërmarrjes publike me këtë akt, i përcakton shpenzimet nga paragrafi (2) i neni 83 të këtij vendimi.

(2) Pëlqim aktit nga paragrafi 1 i këtij neni i jep Këshilli i Qytetit të Shkupit.

(3) Kur mënjanimin e bën subjekti i autorizuar, shpenzimet nga paragrafi (2) i këtij neni 83 të këtij vendimi, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe subjektit të autorizuar, në pajtim me ligjin.

Neni 85

Për mosrespektimin e dispozitës nga neni 77 paragrafi (1) të këtij vendimi, pronarit/shfrytëzuesit të sendit, inspektori komunal i Qytetit të Shkupit ose roja komuna do t'i shqiptojë gjobë në pajtim me Ligjin për veprimtari komunale.

VI. KUSHTET E RUAJTJES SË KAFSHËVE DHE KAFSHËVE MANARË NË OBORRE TË OBJEKTEVE KOLEKTIVE DHE INDIVIDUALE

Neni 86

(1) Në rajonin e Qytetit të Shkupit ndalohet ruajtja, ngasja, kullotja dhe ushqimi i kafshëve dhe shpendëve.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me qentë dhe macet që ruhen si manarë ose si të pastrehë, si dhe kafshët që ruhen në kopshte zoologjike.

(3) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, komunat në qytetin e Shkupit, mund, me këtë akt, të caktojnë pjesë nga rajoni i tyre (lagje me objekte për banim individual ose jashtë pjesës urbane), në të cilat mund të ruhen lloje të caktuara të kafshëve dhe shpendëve (njëthundrakë, dythundrakë, lepuj, pëllumba, bletë, peshq etj.), si dhe t'i caktojnë kushtet për ruajtjen e tyre.

Neni 87

(1) Kafshët manarë doemos duhet të ruhen në mënyrë që të mos pengohen rendi i përcaktuar shtëpiak dhe qetësia dhe siguria e qytetarëve.

(2) Qentë dhe macet, si manarë, mund të ruhen në banesë, në objekt banesor kolektiv ose individual. Ndalohet ruajtja dhe mbajtja e qenve dhe maces në ballkon, terracë ose lozhë që i përket banesës, pa prezencën dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të pronarit të tyre.

(3) Kafshët shtëpiake manarë mund t'i shfrytëzojnë në mënyrë transite vendet e

përbashkëta (ashensorë, shkallë, korridore) vetëm nëse janë të lidhura me zinxhir ose nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të pronarit të tyre. Kafsha manare mund të futet në ashensor vetëm nëse ashensori është bosh.

(4) Me përjashtim, në ndërtesën banesore kolektive, kafshët manarë mund të mbahen dhe ruhen në vende të përbashkëta (lavanderi, vende për tharje të rrobave, vende për vendosje të pajisjes për mirëmbajtje të ndërtesës etj.), vetëm pas pëlqimit paraprak të pronarëve të banesave dhe pjesëve të veçanta të ndërtesës, në pajtim me rregullat për banim.

(5) Për ruajtje dhe ushqim të kafshëve manarë dhe kafshëve endacakë në oborr të përbashkët të objektit banesor kolektiv, pronarët e kafshëve manarë, përkatësisht personat që kujdesen për ruajtjen dhe ushqimin e tyre, doemos duhet të kenë pëlqim me shkrim nga shumica e pronarëve dhe shfrytëzuesve të oborrit, përkatësisht vendim adekuat të bashkësisë së pronarëve të pjesëve të veçanta të ndërtesës, në pajtim me rregullat për banim.

(6) Pronarët e kafshëve manarë, përkatësisht personat që kujdesen për ruajtje dhe ushqim të qenve dhe maceve endacakë në oborr të përbashkët të objektit banesor kolektiv janë të detyruar që ta respektojnë standardin e mirëmbajtjes së pastërtisë, ta mënjanojnë jashtëqitjen nga oborri dhe të kujdesen për respektimin e rregullave për rendin dhe qetësinë publike dhe për banim.

Neni 88

(1) Qeni i cili ruhet në oborr, ruhet në objekt të veçantë. Objekti për ruajtje të qenit doemos duhet të jetë larg së paku 3 metra nga objekti më i afërt banesor ose afarist në parcelën fqinjësore dhe nga vija rregulluese e sipërfaqes publike.

(2) Nëse qeni ruhet në oborr, oborri doemos duhet të rrethohet dhe në vend të dukshëm të vendoset tabelë me vizatim dhe mbishkrim me të cilin paralajmërohet prezenca e qenit, ndërsa në hyrjen në oborrin doemos duhet të ketë zile.

Neni 89

Në aspekt të kushteve që kanë të bëjnë me habitatet, objektet dhe pajisjen, si dhe me ushqimin dhe kujdesin e kafshëve, shpendëve dhe manarëve, regjistrimin e manarëve dhe pronarët e tyre, obligimin që manarët të shënohen (me mikro çip) për shkak të identifikimit, si dhe të vaksinohen dhe dehelmetizohen, vlejné ligjet dhe rregullat tjera nga sfera e mirëqenies së kafshëve dhe veterinarisë.

Neni 90

(1) Nëse pronarët e manarëve nuk u përmbahen dispozitave të këtij vendimi, manarët do të trajtohen si kafshë endacakë dhe ndaj tyre do të zbatohet procedura e kapjes.

(2) Në strehimore sigurohet mbrojtje elementare e kafshëve nga moti i keq dhe furnizohen rregullisht me ushqim dhe ujë, i sigurohet trajtim dhe kujdes shëndetësor, analizë laboratorike, sterilizim, vaksinim, dehelmetizim, shënim të qenve të shëndoshë, sigurohet ruajtja e tyre deri në adoptimin e tyre, ose pas shfrytëzimit të

të gjitha mundësive për adoptim kthehen në rajonin prej ku janë kapur, ndërsa qentë e sëmurë dhe agresivë të cilët mund të përbëjnë rrezik serioz për shëndetin e kafshëve ose njerëzve, do të vriten me mjete të eutanazimit human.

VII. MËNYRA E MIRËMBAJTJES SË PASTËRTISË NË OBORRE, VENDE TË OBJEKTEVE BANESORE KOLEKTIVE DHE INDIVIDUALE

Neni 91

(1) Oborret e objekteve kolektive dhe individuale, si dhe vendet/sipërfaqet që gjenden brenda ose ndërmjet bllokut banesor ose afarist ose ndërmjet objekteve doemos duhet të mirëmbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër.

(2) Për parregullsi dhe mirëmbajtje të pastërtisë së vendeve nga paragrafi (1) i këtij neni kujdeset pronari përkatësisht shfrytëzuesi i oborrit, përkatësisht të gjithë pronarët dhe shfrytëzuesit e oborrit të përbashkët ose vendit.

(3) Ndalohet në oborret lënia, deponimi, përkatësisht grumbullimi i çfarëdo ambalazhi, sendeve të kabashme nga amvisëritë, mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave tjera dhe çfarëdo sende tjera që shkaktojnë shëmtimin e pamjes dhe parregullsi të vendit.

(4) Në oborret që janë me pamje kah rruga ose sheshi, ndalohet:

- tharja e rrobave,
- që bari të jetë më i lartë se 10 cm,
- të mbillen dru frutorë frytet e të cilave e ndotin sipërfaqen publike,
- degët e bimëve dekoruese dhe shkurreve ta kalojnë vijën rregulluese të sipërfaqes publike dhe ta pengojnë sigurinë e komunikacionit dhe lëvizjes së njerëzve.

(5) Personat nga paragrafi (2) i këtij neni janë të detyruar që ta pastrojnë sipërfaqen, ta korrin barin, ta krasisin gardhin e gjallë dhe bimët tjera, të mos lejojnë që bimët ta dëmtojnë ose shëmtojnë sipërfaqen publike, objektet dhe instalimet, ta heqin barin e keq, t'i mirëmbajnë sipërfaqet e betonit, rrugët e aksesueshme, shkallët, sipërfaqet e parkimit, t'i mënjanojnë mbeturinat e ndërtimit dhe mbeturinat tjera dhe të ndërmarrin aktivitete tjera me qëllim që këto sipërfaqe të rregullohen.

(6) Nëse vendet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mirëmbahen mirë dhe pastër, në pajtim me dispozitat e këtij neni, inspektori komunal i Qytetit të Shkupit do t'i urdhërojë personat nga paragrafi (2) i këtij neni që, në afatin e caktuar, t'i mënjanojnë mangësitë e konstatuara në procesverbalin.

(7) Nëse personat nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk veprojnë, në afatin e caktuar, sipas urdhrave të inspektorëve komunalë të Qytetit të Shkupit, mangësitë e

konstatuara do t'i mënjanojë ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar nga Qyteti, në shpenzim të personave nga paragrafi (2) i këtij neni.

Neni 92

Për mosrespektimin e dispozitës nga paragrafi (3) i nenit 91 të këtij vendimi, pronarëve/shfrytëzuesve të vendeve nga paragrafi (1) i nenit 91 të këtij vendimi, inspektori komunal i Qytetit të Shkupit ose roja komunale do t'u shqiptojë gjobë në pajtim me Ligjin për veprimtari komunale.

VIII. MËNYRA E MIRËMBAJTJES DHE PASTRIMIT TË KANALEVE TË HAPURA TË KULLIMIT DHE SHTRËTËRVE TË LUMENJVE

Neni 93

(1) Në kanalet e hapura të kullimit, në shtratin e rregulluar dhe në ujërat e lumit Vardar ndalohet:

- noti,
- gjuajtja e çfarëdo lloji sendi ose mbeturine,
- lëshimi (derdhja) e fekaleve dhe kimikateve.

(2) Veprimet e ndaluara doemos duhet të shënohen në tabela të vendosura në vend të përshtatshëm.

Neni 94

Qyteti i Shkupit kujdeset për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve të hapura të kullimit dhe shtratit të rregulluar të lumit Vardar (në pjesën urbane të qytetit të Shkupit)

Neni 95

Mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve të hapura të kullimit dhe shtratit të rregulluar të lumit Vardar, si dhe vendosjen e tabelave nga paragrafi (2) i nenit 93 e kryen ndërmarrja publike ose subjekti i autorizuar.

IX. DEZINSEKTIMI

Neni 96

Qyteti i Shkupit, përmes programit të cilin e miraton Këshilli i Qytetit të Shkupit, siguron spërkatje nga ajri (dezinsektim me aerosol) për eliminimin e insekteve të dëmshme (miza, mushkonja etj.) dhe dezinsektim tokësor për eliminimin e insekteve të cilat nuk mund të eliminohen me spërkatje nga ajri.

Neni 97

Dezinsektimi bëhet tre deri në pesë herë në vit dhe atë në periudhën maj-shtator, në përputhje me programin nga neni 96 të këtij vendimi ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, e në përputhje me standardet dhe normativat e përcaktuara.

Neni 98

Qëllimi i dezinfektimit është ruajtja e shëndetit të qytetarëve, eliminimi i burimeve të sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i mundësisë për bartje të infeksioneve.

Neni 99

Dezinsektimin e bën subjekti i autorizuar, i caktuar nga Qyteti i Shkupit, në bazë të marrëveshjes, në të cilën përcaktohet më afërsisht procedura dhe mënyra e kryerjes, periudha e kryerje së aktiviteteve, mjetet e nevojshme, si dhe të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të Qytetit të Shkupit dhe subjektit të autorizuar.

Neni 100

Kryetari i Qytetit të Shkupit, përmes mjeteve të informimit publik, e njofton në kohë publikun për kohën dhe mënyrën e spërkatjes nga ajri, dezinfektimit dhe për masat mbrojtëse që duhet t'i ndërmarrin qytetarët.

X. MASAT E ZBATIMIT TË DISPOZITAVE NGA VENDIMI

Neni 101

(1) Mbikëqyrje inspektuese mbi ndërmarrjet publike për kryerje të veprimtarive komunale të themeluara nga Qyteti i Shkupit dhe subjektet e autorizuar të cilëve qyteti i Shkupit u ka besuar kryerje të veprimtarive komunale adekuate në pajtim me ligjin, si dhe mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të këtij vendimi, kryejnë inspektorët komunale të Qytetit të Shkupit.

(2) Zbatimi i dispozitave të caktuara të këtij vendimi në të cilat janë përcaktuar ndalime ose obligime për ndërmarrje të aktiviteteve ose për t'u përmbajtur nga ndërmarrja e tyre, inspektorët komunalë të Qytetit të Shkupit do ta sigurojnë përmes bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me organet e administratës shtetërore ose komunave në qytetin e Shkupit ose me personat e autorizuar në këto organe (nëpunës policorë me uniformë, inspektorë të autorizuar për banim në komunat në qytetin e Shkupit, inspektorë të Inspektoratit shtetëror komunal, inspektorë komunalë në komunat në qytetin e Shkupit, inspektorë të autorizuar të mjedisit jetësor, inspektorë shtetëror të mjedisit jetësor etj.) të cilët në pajtim me ligjin dhe rregullat tjera janë kompetentë për veprim për materien adekuate.

Neni 102

Inspektori komunal i Qytetit të Shkupit ka të drejtë dhe detyrë që:

- ta ndjekë zbatimin e këtij vendimi dhe rregullat dhe aktet e miratuara në bazë të këtij vendimi;
- t'ua tërheqë vërejtjen personave juridikë dhe fizikë për sjelljen që nuk është në pajtim me ligjin dhe me këtë vendim edhe të kërkojë prej tyre ndërmarrje të masave adekuate;
- të urdhërojë kryerje të punëve, nëse konstaton se ato nuk kryhen përkatësisht kryhen në mënyrë të parregullt ose nuk kryhen në mënyrë të plotë;
- të ndalojë kryerje të punëve pa leje të organit kompetent, përkatësisht në kundërshtim me atë leje;
- urdhërojë mënjanim të objekteve, aparateve dhe pajisjes, të vendosura në kundërshtim me dokumentacionin urbanistik-teknik;
- t'i njoftojë organet kompetente ose personat e autorizuar dhe të kërkojë veprim dhe ndërhyrje të tyre në raste nga paragrafi (2) i nenit 101 të këtij vendimi
- të ngrejë procedurë para gjykatës kompetente dhe
- të ndërmarrë edhe veprime dhe masa tjera për të cilat është i autorizuar.

Neni 103

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori komunal i Qytetit të Shkupit i ndjek dhe i konstaton gjendjet dhe ndërmerr masa, me ç'rast është i detyruar që të përpilojë procesverbal dhe t'ia dorëzojë subjektit të cilit i referohet inspektimi.

(2) Në bazë të procesverbalit nga paragrafi (1) i këtij neni inspektori komunal i Qytetit të Shkupit sjell aktvendim me të cilin e përcakton mënyrën dhe afatin e mënjanimit të mangësisë.

(3) Nëse subjekti nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e mënjanon vet mangësinë, inspektori komunal i Qyteti të Shkupit do të sjellë konkluzion për leje për përmbarim, me ç'rast shpenzimet bien në barrë të subjektit.

Neni 104

(10) Për veprim në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, inspektori komunal i Qytetit të Shkupit do t'i shqiptojë autorit (kryerësit) gjobë në pajtim me ligjin.

(2) Për veprim në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi autorit (kryerësit) - personit fizik gjobë në pajtim me Ligjin për veprimtari komunale mund t'i shqiptojë edhe roja komunale.

(3) Autori (kryerësi), krahas gjobës, është i detyruar që t'i paguajë shpenzimet e parapara në vendimin, si dhe kompensimin e dëmit.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 105

Me hyrjen e këtij vendimi në fuqi shfuqizohet Vendimi për rendin komunal në Qytetin e Shkupit ("Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 6/98, 16/01, 7/03 dhe 12/03).

Neni 106

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në "Fletoren zyrtare të Qytetit të Shkupit".

Numër 07– 4689/1

7 korrik 2014

Shkup

KËSHILLI I QYTETIT TË SHKUPIT

KRYETAR ,

mr. Irena Misheva, d.v.